



**REPUBLIKA E SHQIPERISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**

**DOKUMENTAT STANDARDE TË KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT  
PËR DHËNIEN ME KONCESION PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN,FINANCIMIN,  
OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN, REHABILITIMIN DHE TRANSFERIMIN E SEGMENTIT  
RRUGOR MILOT - BALLDRE**

# NJOFTIMI I KONTRATËS

## I Autoriteti Kontraktor

### Seksioni 1

#### Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë  
Adresa Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 1001, Tiranë  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Faqja e Internetit [www.infrastruktura.gov.al](http://www.infrastruktura.gov.al)

### 1.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion qendror

Institucion i pavarur

☒

☐

Njësi e Qeverisjes Vendore

☐

### Seksioni 2 Objekti i kontratës

### 2.1 Lloji i Kontratës

Punë

☒

### 2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat

- Objekti i kontratës Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim dhe transferim i segmentit rrugor “Milot-Balldre”
- Forma e kontratës Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim dhe transferim
- Vlera e Totale e parashikuar për Kontratën është 364,732,924 EUR pa TVSH. Në këtë vlerë përfshihen shuma e Vlerës së Projektimit, Vlerës së Operimit, vlerës së Mirëmbajtjes rutinë dhe kapitale.
  - Vlera e parashikuar e Projektit është 3,650,964 EUR pa TVSH (Projektimi) plus 182,548,198 EUR pa TVSH (Ndërtim, rehabilitim) plus 10,122,482 EUR pa TVSH (Sistemi i Pagesës (toll))
  - Vlera e parashikuar e Operimit është 84,979,849 EUR pa TVSH (Operimi)
  - Vlera e parashikuar e Mirëmbajtje Rutinë dhe Kapitale është 83,431,431 EUR pa TVSH
- Burimi i financimit: Investim Partneri Privat

Kujdes:

Vlera e totale e ofertuar e kontratës nga ofertuesit, nuk duhet të jetë në një shumë më të vogël se Vlera 364’732’924 EUR pa TVSH.

### 2.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja 35 (tridhjetë e pesë) vjet

### 2.4 Vendndodhja e objektit të kontratës:

Gjurma e propozuar e rrugës “Milot-Balldre” fillon në nyjen e Milotit, ku do të lidhet me segmentet e tjera rrugore Milot-Thumanë-Kashar-Lekaj dhe me Rrugën e Kombit, dhe do të përfundojë në rrugën ekzistuese Tiranë –Shkodër, në Balldre.

### **Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik**

#### **3.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojcës nr. 9.**

#### **3.2 Sigurimi i Ofertës:**

Operatori Ekonomik në një procedurë koncesioni/partneritetit publik privat, paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 3.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e vlerës Totale të Kontratës të ofertuar.

### **Seksioni 4 Procedura**

#### **4.1 Lloji i procedurës:**

| E hapur | E kufizuar               | Me negociim<br>me shpallje<br>paraprake |
|---------|--------------------------|-----------------------------------------|
| X       | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/>                |

#### **4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

Lidhur me rëndësinë:

|     |                                                                                                                                                      |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a/a | <b>KRITERET TEKNIKE</b>                                                                                                                              |
| (1) | Propozim teknik për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës                                                                                              |
|     | a. Projekt – ide konceptuale                                                                                                                         |
|     | b. Metodologjia e punimeve                                                                                                                           |
|     | c. Plani operacional i mirëmbajtjes dhe disponueshmërisë                                                                                             |
|     | d. Mbrojtja e shëndetit dhe jetës                                                                                                                    |
| (2) | <b>Ndikimi Mjedisor</b>                                                                                                                              |
| (3) | <b>Ndikimi Social</b>                                                                                                                                |
| (4) | <b>Afati për përfundimin e punimeve</b>                                                                                                              |
|     | a. Milot - Balldre                                                                                                                                   |
| a/a | <b>KRITERET FINANCIARE</b>                                                                                                                           |
| (1) | Vlera toll/km/pcu                                                                                                                                    |
| (2) | Garancia – niveli bazë i të ardhurave (nën nivelin e të ardhurave bazë – Shteti nga viti i parë i operimit deri në maksimumi vitin e 17 të operimit) |
| (3) | Shuma maksimale e kërkuar e Garancisë (nga viti i parë i operimit deri në maksimumi vitin e 17 të operimit)                                          |
| (4) | Shpërblimi – niveli bazë i të ardhurave (nën nivelin e të ardhurave bazë – Shteti përgjatë gjithë periudhës së koncesionit - vjetore)                |
| (5) | Përqindja e shpërblimit                                                                                                                              |

**Shpërndarja e pikëve dhe metodologjia përcaktohen në shtojcën 11**

#### 4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 02.10.2025

Ora: 12:00

Vendi: Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike në sistemin e APP

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**

#### 4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 02.10.2025

Ora: 12:00

Vendi: Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike në sistemin e APP

**Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

#### 4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150 ditë

#### 4.6 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

|        |                                     |          |                                     |
|--------|-------------------------------------|----------|-------------------------------------|
| Shqip  | <input checked="" type="checkbox"/> | Anglisht | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Tjetër | <input type="checkbox"/>            |          |                                     |

Shënim: Dokumentet të lëshuara/përgatitura në gjuhën shqipe nuk duhen shoqëruar në gjuhën angleze ndërsa dokumentat e lëshuara/përgatitura në gjuhë të huaj, duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

### **Seksioni 5 Informacione plotësuese**

#### 5.1 Dokumenta me pagesë:

|    |                          |    |                                     |
|----|--------------------------|----|-------------------------------------|
| Po | <input type="checkbox"/> | Jo | <input checked="" type="checkbox"/> |
|----|--------------------------|----|-------------------------------------|

5.2 Vlera e tarifës që duhet të paguhet nga operatori ekonomik në rast të një ankese pranë Komisionit të Prokurimit Publik është sipas legjislacionit në fuqi.

5.3 Vlera e tarifës së ATRAKO, referuar Nenit 12 të Ligjit Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285 datë 10.04.2020 “Për organizimin, funksionimin si dhe procedurat e niveli i tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)”, është Shuma që do të paguhet për shërbime të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) nga ofertuesi fitues para nënshkrimit të Kontratës.

5.4 Vlera e tarifës që duhet të paguhet nga ofertuesi i suksesshëm për Shërbimin e Monitorimit Koordinimit të Shërbimit të Operimit të realizuar nga Enti Kombëtar i Operimit Rrugor, është Tarifa për EKORR në përputhje me parashikimet e VKM Nr. 684, datë 6.11.2024 “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Enti Kombëtar i Operimit Rrugor” sha”.

5.5 Informacione shitesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumenteve të procedurës konkurruese).

5.6 Krijimin nga ofertuesi i përzgjedhur si më i suksesshmi, i një subjekti për qëllime të veçanta (SPV), të rregulluar sipas legjislacionit në fuqi, si një shoqëri me seli në Republikën e Shqipërisë me shënimin para emrit “Shoqëri Koncesionare” dhe me objekt “Objektin e Kontratës së Koncesionit.

Agjencia e Prokurimit Publik: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi 11.08.2025

## II. UDHËZIME PËR OFERTUESIT

### 1. HYRJE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur të implementojë projektin për dhënie me koncesion/partneritet publik privat për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Milot - Balldre.

Përzgjedhja e Ofertuesit Fitues do të bëhet në bazë të një procedure konkurruese (procedurë e hapur) sipas kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese të specifikuara në këtë dokument.

Kohëzgjatja e kontratës koncesionare/PPP do të jetë për një periudhë 35 (tridhjetë e pesë) vjet nga hyrja në fuqi e saj. Kjo Kontratë hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët dhe pas botimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave të miratimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

#### 1.1 Informacion i mëtejshëm:

Korridori Adriatik-Jon (AIC) është i identifikuar paraprakisht si pjesë e Korridorit TEN-T Mesdhetar (siç paraqitet në hartën më poshtë), duke shtrirë Korridorin Kryesor të Rrjetit të BE-së në Rajonin e Ballkanit Perëndimor (Rregullorja e KE 2016/758 duke ndryshuar rregulloren Nr. 1315/2013). Ai do të lidhë Evropën Qendrore dhe Italinë e Veriut me Ballkanin në Evropën Juglindore, me Slloveninë, Kroacinë, Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Shqipërinë dhe Greqinë.

Gjatësia e vlerësuar e të gjithë Korridorit të Mesdheut është rreth 1550 km. Në Ballkanin Perëndimor, korridori kalon nëpër Mal të Zi (afërsisht. 7% e gjatësisë totale) dhe Shqipëri (afërsisht 20% e gjatësisë totale ose 318 km). Krijimi i rrjetit synon të forcojë sigurinë në rrugë, planifikimin e transportit, lidhjen rajonale, lëvizjen, konkurrencën dhe integrimin me rrjetin TEN-T të BE-së.

Segmenti ekzistues i rrugës që shërben për drejtimin nga Miloti në Balldre dhe zonat përreth, është me dy drejtime (vajtje-ardhje). Rruga ekzistuese ka një gjatësi më të madhe nga propozimi i ri, parametra teknik të lëvizjes në këtë rrugë janë të një niveli shumë të ulët. Kjo rrugë kalon nëpër qytetin e Lezhës, me trafik shumë të rënduar dhe rrjedhimisht, ka kohë më të gjatë udhëtimi dhe konsum më të madh karburanti etj.

Seksionet e rrugës ekzistuese funksionojnë brenda kapacitetit të tyre, por në periudha të ndryshme sidomos gjatë sezonit veror mbingarkohet jashtë kapacitetit, si efekt i frekuentimit të plazheve që ndodhen në këtë zonë (plazhi i Shëngjinit, plazhi i Tales, plazhi i Velipojës) dhe portit të Shëngjinit. Sipas parashikimit të kërkesës së trafikut, kapaciteti do të tejkalohet së shpejti, duke rritur numrin e automjeteve në qarkullim, duke sjell pamundësinë e përballimit të këtij kapaciteti nga rruga ekzistuese.

Autostrada e re do të shtrihet nga Miloti në Balldre, si vazhdim i autostradës Kashar-Thumanë-Milot, duke përmirësuar këtë pjesë nga rrugë kategoria "C" në autostradë të kategorisë "A". Aksi Milot-Balldre që parashikohet në këtë studim është i gjatë rreth 17 km. Seksioni i propozuar plotëson karakteristikat e një autostrade të kategorisë A. Ky aks do të ketë një karrexhatë dyfishe me nga dy korsi, me një ndarëse korsish dhe korsi të emergjencës, bankine, tunel me dy tuba, vepra arti të mëdha mbi lumin Mat dhe lumin Drin, vepra arti të vogla, rrugët paralele të kategorisë F2, nyjet në disnivel bashkë me rrugët lidhëse, rrugë alternative pa pagesë kategoria "C", e cila duhet të ndodhet në një distancë rreth 1 km por jo më shumë se 1.5 km nga aksi kryesor i rrugës Milot-Balldre, në rast se ofertuesi zgjedh të përdorë rrugën ekzistuese

dhe në rast se ofertuesi zgjedh të ndërtojë një aks të ri jashtë aksit ekzistues, rruga ekzistuese mund të shfrytëzohet si rrugë alternative pa pagesë, duke respektuar parametrat e kategorisë dhe distancës të sipërcituara, si dhe operimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Operimit përfshirë kabinat, sistemin e portave të automatizuara për lejimin e hyrje daljeve në Rrugë, sensorët e trafikut dhe elementet e tjera matëse, sistemin elektronik për mbledhjen e Tarifave dhe të monitorimit të trafikut, serverat e nevojshëm për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave të trafikut dhe të arkëtimeve përkatëse, si dhe çdo element tjetër të nevojshëm për realizimin e shërbimit të mundësimit të aksesit në Rrugë të Përdoruesve, arkëtimin e Tarifës, kontrollin e trafikut dhe ofrimin e ndihmës për Përdoruesit, parandalimin e shkeljeve, duke përfshirë reagimin në rast ndërhyrjesh urgjente etj.

- 1.2 Këto udhëzime ("Udhëzimet për Ofertuesit") si dhe "Ftesa për Ofertë" i adresohet të gjithë subjekteve juridike ose bashkimeve të tyre, që kanë për qëllim të marrin pjesë në këtë procedurë konkurruese përzgjedhjeje.
- 1.3 Shpenzimet: Ofertuesi Fitues duhet të përballojë shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij si dhe çdo shpenzim tjetër ashtu siç parashikohet në këto dokumente në përputhje me ligjin nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" i ndryshuar.
- 1.4 Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të ndërprerë përfundimisht këtë Procedurë konkurruese përzgjedhëse. Ofertuesi nuk ka asnjë të drejtë për të kërkuar ndonjë kompensim për kostot ose humbjet.
- 1.5 Për efekt të llogaritjeve, për sa nuk është parashikuar ndryshe në këto dokumente, të merret për bazë Kursi i Bankës së Shqipërisë për këmbimin e monedhave të huaja, të datës së publikimit të njoftimit të Kontratës.

## **2. Dokumentet e Procedurës Konkurruese**

### **2.1 Përmbajtja**

#### **2.1.1 Lloji i projektit dhe kërkesat teknike, procedura e konkurrimit, kushtet e kontratës dhe kërkesat ligjore dhe ekonomike financiare përcaktohen në dokumentet e procedurës konkurruese të cilat përmbajnë :**

##### **SHTOJCAT**

Shtojca 1: Formulari i Ofertës

Shtojca 2: Formulari i Ftesës për Ofertë i Procedurës së Kufizuar ose Me Negocim me Shpallje

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Formulari i Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklarate mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike nga operatori ekonomik

Shtojca 6: Deklarata për konfliktin e interesit

Shtojca 7: Formular i vlerësimit për realizimin e punimeve

Shtojca 8: Mbi Disponimin e Makinerive

Shtojca 9: Kriteret e përgjithshme/veçanta të pranimi/kualifikimit

Shtojca 10: Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore

Shtojca 11: Kriteret e vlerësimit

Shtojca 12: Vetëdeklarim për ofertuesit e huaj

Shtojca 13: Projekt-zbatimi dhe specifikimet teknike

Shtojca 14: Preventivat

Shtojca 15: Njoftim Standart për Ofertuesin e Skualifikuar

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 17: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 18: Kushtet e Veçanta të Kontratës

Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 20: Formulari i Publikimit të Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

Shtojca 21: Formulari i Ankesës prane Autoritetit Kontraktor

Shtojca 22: Formulari i Prokurës

#### **2.1.2 Çdo ofertues duhet të marrë në konsideratë udhëzimet, kriteret, kushtet, specifikimet, afatet dhe të gjithë informacionin në dokumentet e procedurës konkurruese. Në rast se ofertuesi:**

- i) nuk plotëson të gjithë dokumentacionin dhe informacionin në dokumentet e procedurës konkurruese; ose
- ii) paraqet një ofertë e cila nuk është në përputhje me kushtet dhe kërkesat e dokumenteve të procedurës konkurruese.

Autoriteti kontraktues do të përcaktojë se oferta nuk është në përputhje me kërkesat e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe do të refuzojë ofertën.

## **2.2 Sqarime mbi Dokumentet Standarte të Procedurës Konkurruese:**

#### **2.2.1 Ofertuesi i cili kërkon sqarime apo ndryshime të dokumenteve të procedurës konkurruese, duhet të paraqesë kërkesën e tij nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik. Të gjitha përgjigjet së bashku me sqarimet përkatëse, duhet tu bëhen të njohura të gjithë të interesuarve.**

## **2.3 Ndryshimet në dokumentet e procedurës konkurruese:**

- 2.3.1** Në çdo kohë para afatit të dorëzimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues në çdo rast që bën ndryshime në dokumentet e procedurës duhet të shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave sipas ligjit. AK mund për çdo arsye, me nismën e tij ose në përgjigje të kërkesave për ndryshime nga një ofertues, të ndryshojë dokumentet e procedurës konkurruese.
- 2.3.2** Të gjitha ndryshimet e kryera nga Autoriteti Kontraktues do të publikohen në faqen e internetit të APP. Dokumentet e ndryshuara do të konsiderohen si dokumentet e procedurës konkurruese për këtë procedurë përzgjedhëse konkurruese.
- 2.3.3** Në mënyrë që ofertuesit të kenë kohë të mjaftueshme për të bërë ndryshimet përkatëse në ofertën e tyre, Autoriteti Kontraktues mund, që me nismën e tij të shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues sipas ligjit “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” të ndryshuar, do të publikojë afatin e ri për dorëzimin e ofertave në faqen e internetit të APP.

## **3. OFERTA: PËRGATITJA**

### **3.1. Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

- a) Formulari i Ofertës, plotësuar në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojcat 1 e DSK/PPP.
- b) Formulari i Sigurimit të ofertës, kur kërkohet, duhet plotësuar në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojcat 3 e DSK/PPP.
- c) Dokumentat që lidhen me objektin e koncesionit/partneritetit publik privat (*skica, projekte, etj*)

#### **a) Ofertën Ligjore dhe kriteret e detyrueshme**

Ofertuesit paraqesin një Formular të Deklarimit të Ofertës (Shtojca 1), i cili përmban, ndër të tjera, një deklaratë që konfirmon se ata i pranojnë kushtet e Projekt-Kontratës së Koncesionit, pjesë e këtij dokumenti. Nëse Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, Shtojca 1 – Formulari i Ofertës duhet të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i secilit anëtar të Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive ose nga përfaqësuesit e tij, siç parashikohet në Marrëveshjen e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive.

Ofertuesit paraqesin kopje të vendimit të bordit të drejtorëve, aksionarëve dhe / ose organeve drejtuese përkatëse të Ofertuesit për Dorëzimin e Ofertës dhe Miratimin nga Ofertuesi që nënshkruan dhe zbaton Kontratën Koncesionare. Në rastin e një Bashkimi të Përkohshëm të Shoqërive, këto vendime kërkohen nga secili prej anëtarëve të Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive të përcaktuara në Marrëveshjen e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive.

Ofertuesit paraqesin rregullisht një autorizim përfaqësimi, i cili mban një vulë apostile të ligjshme (nëse ekzekutohet në praninë e një Autoriteti Publik), siç përcaktohet në këtë dokument.

Ofertuesit paraqesin Sigurimin e Ofertës në formularin e specifikuar në Shtojcën 3 të këtij dokumenti.

Ofertuesit paraqesin informacionin e kërkuar në Shtojcat 9 dhe 10 për të treguar se Kandidati i përmbush kriteret ligjore, teknike dhe financiare.

## **b) Oferta Financiare**

Niveli i Garantimit të një Minimumi të Ardhurash (Minimum Revenue Guarantee (MRG))

Ofertuesi do të dorëzojë formularin e përcaktuar në Shtojca 11 “Kriteret e vlerësimit” të këtij Dokumenti të Procedurës Konkurruese, që përcakton Nivelin e Garantimit të një Minimumi të Ardhurash të kërkuara prej Autoritetit Kontraktor nga Ofertuesi.

## **c) Modeli Financiar**

Ofertuesit do të dorëzojnë një model financiar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 9 të këtij Dokumenti të Procedurës Konkurruese. Modeli financiar i Ofertuesit të Suksesshëm që do të hartohet në monedhën Euro, do të auditohet dhe do të bëhet Modeli Financiar Referencë pas shqyrtimit dhe miratimit nga Autoriteti Kontraktor. Modeli financiar i Ofertuesve duhet të hartohet në përputhje me pikat 3 e vijuese të nenit 7 të Vendimit nr. 575, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave për Vlerësimin dhe Dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat” të ndryshuar për aq sa është e aplikueshme.

Për qëllimin e këmbimit Euro / Lekë në modelet financiare, Ofertuesit do të përdorin kursin e këmbimit për Euro / Lekë të përcaktuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë në datën e publikimit të kësaj procedure.

## **d) Oferta Teknike**

Çdo Ofertues duhet të përgatisë Projekt Ide Konceptuale për aksin rrugor Milot - Balldre, Metodologjinë e Punimeve dhe Grafikun e Punimeve dhe të përgatisë Planin Operacional për mirëmbajtjen dhe operimin, siç përcaktohet në pikat në vijim:

Gjatë përgatitjes së Projekt Ide Konceptuale, çdo Ofertues, mbështetur në metodologjinë e propozuar të ndërtimit, do të paraqesë pa cenuar cilësinë dhe standardin e kërkuar, por pa u kufizuar, propozimin e një oferte teknike duke konsideruar edhe modifikimin e elementeve duke pasur si synim parësor përmirësimin/rritjen e standardit.

Informacioni i kërkuar në Shtojcën 9 vlen për të përcaktuar nëse Ofertuesi përmbush kriteret e përzgjedhjes.

## **e) Zhvillimi i Projekt Idesë Konceptuale do të kryhet në përputhje me kategoritë e rrugës dhe dispozitat ligjore:**

- ✓ VKM Nr.1243, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës të personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit” i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodin Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton kategoritë e rrugëve, autoritetet përgjegjëse për kontrollin e rrugëve dhe përmasat maksimale të lejuara dhe ngarkesën e automjeteve;
- ✓ Ligji Nr.10440 datë 7.7.2011; “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- ✓ Ligji Nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar;

- ✓ Ligji Nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr.125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- ✓ VKM Nr.575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e Rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar;
- ✓ VKM Nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.107/2014: “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” i ndryshuar;
- ✓ VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”;
- ✓ Ligji Nr.10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar” (ARRSH);
- ✓ Ligji Nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.158/2013 “Për Sigurinë në Tunelet Rrugore”;
  - ✓ Rregulli Teknik për projektimin e rrugëve miratuar me Vendimin Nr. 628, datë 15.7.2015 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve” të ndryshuar;
  - ✓ SSH EN 1992-1-2 Eurokodi 2 Projektimi i strukturave të betonit
  - ✓ SSH EN 1997-1; 2004 Eurokodi 7 Projektimi Gjeoteknik
  - ✓ SSH EN 1998-5:2004 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit - Pjesa 5: Themelet, strukturat mbajtëse dhe aspekte gjeoteknike;
  - ✓ Standarti CIE 88/2004 (standard për ndricimin e nënkalimeve dhe tuneleve), ose ekuivalent
- ✓ Urdhri nr.185 datë 18.06.2020 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Për zbatimin e strategjisë për aplikimin e Sistemeve Inteligjente në Transportin Rrugor” dhe çdo standard tjetër të miratuar nga institucione shqiptare dhe praktikat më të mira europiane;
- ✓ VKM Nr. 684, datë 6.11.2024 “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Enti Kombëtar i Operimit Rrugor”sha”.

**f) Punimet e Ndërtimit do të përfshijnë minimalisht seksionet dhe përmbajtjen e mëposhtme:**

- Metodologjinë e Realizimit të Punimeve të Ndërtimit, sipas Projekt-Idesë Konceptuale, të hartuar nga Ofertuesi
- Grafiku i Punimeve bazuar në Projekt Idenë Konceptuale, të hartuar nga Ofertuesi
- Kapacitetin e kantierit me makineri dhe pajisje.

- Mbrojtja e Shëndetit dhe Jetës: Politikat e Ofertuesit lidhur me mbrojtjen e shëndetit dhe Sigurinë, organizimin dhe përgjegjësitë, sigurimin e një zyre dhe Nëpunësi të Sigurisë (punonjës i posaçëm për parandalimin e aksidenteve), trajnimet e punonjësve, kërkesat për ndërtim të sigurt, procedurat e vlerësimit dhe menaxhimit të riskut, masat për ruajtjen dhe përpunimin e materialeve të rrezikshme, objektet për kujdesin mjekësor dhe social në terren, procedurat për ngjarjet e jashtëzakonshme, menaxhimin e trafikut dhe kufizimin e shpejtësisë.
- Ndikimi Mjedisor dhe Social: (i) politikat mjedisore (ii) procedurat për zbutjen e ndikimeve negative (iii) procedurat e monitorimit (iv) procedurat për vlerësimin dhe auditimin, dhe (v) procedurat për konsultimin dhe informimin e publikut.
- Planet për Shërbimet e Mirëmbajtjes dhe Operimit, do të përfshijnë minimalisht të gjithë seksionet e mëposhtme dhe do të përmbajnë: planin për Kontrollin e Cilësisë, që përfshin organizimin e propozuar dhe përgjegjësitë për inspektimin, marrjen e kampionëve dhe testimin e materialeve dhe punimeve për mirëmbajtjen e seksioneve ekzistuese të korridorit të Milot-Balldre, skemat dhe planet e operimit të seksionit rrugor, operimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Operimit përfshirë kabinat, sistemin e portave të automatizuara për lejimin e hyrje daljeve në Rrugë, sensorët e trafikut dhe elementet e tjera matëse, sistemin elektronik për mbledhjen e Tarifave dhe të monitorimit të trafikut, serverat e nevojshëm për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave të trafikut dhe të arkëtimit përkatës, si dhe çdo element tjetër të nevojshëm për realizimin e shërbimit të mundësimit të aksesit në Rrugë të Përdoruesve, arkëtimin e Tarifës, kontrollin e trafikut dhe ofrimin e ndihmës për Përdoruesit, parandalimin e shkeljeve, duke përfshirë reagimin në rast ndërhyrjesh urgjente.
- Planin e Sigurimit të Cilësisë: një përshkrim i qasjes së propozuar për kontrollin e cilësisë, që përfshin procedurat, metodat, personelin dhe burimet e tjera për të siguruar cilësinë e hartimit të projektit të zbatimit, punimeve të ndërtimit dhe shërbimeve operacionale dhe të mirëmbajtjes në përputhje me kërkesat kontraktuale.

***\*Kostot totale të financimit, projektimit, ndërtimit, rehabilitimit, operimit dhe mirëmbajtjes së autostradës të detajuara në planin e biznesit të Ofertuesit do të mbulohen nga Ofertuesi.***

**g) Organizimi: një organigramë e Ofertuesit, ku përfshihen njësitë kryesore administrative, një përshkrim i shkurtër i pozicioneve kyçe drejtuese dhe teknike dhe dosjet mbi përvojën e personelit kyç, si dhe numrin e përafërt të përgjithshëm të punonjësve në njësitë kryesore organizative për fazën e ndërtimit, operimit dhe për fazën e mirëmbajtjes.**

**i. Kontrolli i Trafikut:** Një plan i përgjithshëm për kontrollin e trafikut dhe ofrimin e ndihmës për përdoruesit, duke përfshirë reagimin në rast emergjence, përllogaritjet e stafit dhe kërkesa për burime të tjera. Planet e operimit të sistemeve ITS, Tolling dhe çdo sistemi inteligjent të instaluar në seksionin rrugor Milot-Balldre.

**ii. Mirëmbajtja:** një plan i përgjithshëm për veprimtaritë e inspektimit dhe riparimit; mirëmbajtjes rutinë, ku përfshihet mirëmbajtja dimërore, së bashku me përshkrime të shkurtra të metodave dhe teknikave që do të përdoren, planifikimin, sistemet e kontrollit dhe raportimit, monitorimin dhe vlerësimin e performancës, përllogaritjet e personelit dhe kërkesa për burime të tjera.

Planet për shërbimet e operimit dhe mirëmbajtjes duhet të përfshijnë minimalisht pikat e mëposhtme:

1. Menaxhimin e Trafikut (menaxhimi i përhershëm dhe i përkohshëm i trafikut).

2. Procedurat e emergjencës, duke përfshirë mbylljen e korsive në raste të situatave të emergjencës (incidente, aksidente, por jo vetëm). Plani alternativ në raste emergjence.
3. Operimin e sigurt të autostradës Milot-Balldre dhe sigurinë e përdoruesve dhe forcës së punës së Koncesionarit dhe vizitorët e lejuar në rrugë në përputhje me planin e Shëndetit dhe Sigurisë.
4. Përshkrimin e strukturës së raportit të zakonshëm.
5. Udhëzimet për mirëmbajtjen e autostradës Milot-Balldre, duke përfshirë komponentët strukturorë dhe jostrukturorë, pajisjet dhe makineritë.
6. Procedurat për planifikimin e punimeve për mirëmbajtjen rutinë dhe rehabilitimet e nevojshme.
7. Organizimin e shoqërisë.

**iii.** Mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë: politika e Ofertuesit mbi mbrojtjen e shëndetit dhe jetës, organizimin dhe përgjegjësitë, caktimin e nëpunësit të sigurisë (nëpunësi i parandalimit të aksidenteve), trajnimin e stafit, kërkesat për ndërtim të sigurt, procedurat e vlerësimit dhe menaxhimit të riskut, ruajtjen dhe trajtimin e materialeve të rrezikshme, objektet për kujdesin mjekësor dhe social në terren, procedurat për raste emergjence, menaxhimin e trafikut dhe kufizimin e shpejtësisë.

**iv.** Ndikimi Mjedisor dhe Social (i) politikat mjedisore (ii) procedurat për zbutjen e ndikimeve negative (iii) procedurat e monitorimit (iv) procedurat për vlerësimin dhe auditimin, dhe (v) procedurat për konsultimin dhe informimin e publikut.

**v.** Dokumentet që lidhen me objektin e koncesionit/partneritetit publik privat (skicat, projektet, etj.)

Për sa i përket risqeve të cilat do të merren përsipër nga partneri privat (Ofertuesi) dhe ato të cilat janë të ndara midis partnerit publik dhe atij privat, jepen në tabelën e mëposhtme:

| <b>LLOJI I RISKUT QE MERREN NGA PARTNERI PRIVAT</b> | <b>LLOJI I RISKUT I NDARË MIDIS PARTNERIT PUBLIK DHE PRIVAT</b> |
|-----------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|
| Risku i projektimit                                 | Risku i trojeve                                                 |
| Risku i ndërtimit                                   | Risku i kërkesës                                                |
| Risku i disponueshmërisë gjatë operimit             | Risku i përfundimit në kohë                                     |
| Risqet financiare                                   | Risku i ndryshimit të teknologjisë                              |
| Risku i vjetërimit të rrugës                        | Risku i ndryshimit të kuadrit ligjor                            |
|                                                     | Risku i forcës madhore                                          |

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Çdo e dhënë e rreme nga Ofertuesit, do të përbëjë për Autoritetin Kontraktues shkakun ligjor për skualifikimin në çdo kohë të tyre. Nëse kjo zbulohet ose njoftohet pas lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i japë fund marrëdhënieve të kontratës në mënyrë të njëanshme dhe të marrë dëmshpërblim për humbjet aktuale. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dhënia e informacioneve të rreme, përpilimi i dokumenteve të rreme apo të falsifikuara si dhe çdo deklaratë

apo ndonjë e dhënë tjetër, që nuk pasqyron të vërtetën, konsiderohet vepër penale.

Ofertuesi duhet të përdorë vetëm Dokumentet e Procedurës Konkurruese, pa i bërë asnjë ndryshim përmbajtjes së tyre.

### **3.2 Sigurimi i Ofertës:**

**3.2.1** Si pjesë e ofertës së tij teknike ofertuesi duhet të paraqesë Sigurimin e Ofertës, sipas Formularit të Sigurimit të Ofertës (paraqitur në Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës), në vlerën 2% të vlerës Totale të ofertuar të Kontratës.

**3.2.2** Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, është i detyrueshëm të paraqitet në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë aktivitet. Ofertuesi duhet të garantojë, që Sigurimi i Ofertës të jetë i vlefshëm për një periudhë 30 ditë pas përfundimit të vlefshmërisë së ofertës, e cila është 150 ditë. Pra oferta duhet të sigurohet për 180 ditë nga data e përfundimit të afatit të dorëzimit të saj. Për arsye të motivuara Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga Ofertuesi zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës, në rast se rrethana të caktuara ndikojnë në shtyrjen e afatit të vlerësimit të ofertës përkatëse ose në dorëzimin e Sigurimit të Kontratës ose në çdo rast tjetër që ndikon në shtyrjen e ndonjë afati të detyrueshëm. Mos shtyrja e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës përbën shkak për skualifikimin e Ofertuesit.

**3.2.3** Sigurimi i Ofertës, nëse është kërkuar, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Çdo ofertë e pashoqëruar me Sigurimin e Ofertës do të refuzohet nga Komisioni i Dhënies me Koncesion.

Sigurimi i Ofertës duhet të paraqitet në emër të:

i) shoqërisë, në rast se Ofertuesi është një shoqëri e vetme;  
ose

ii) në emër të shoqërisë kryesuese në rast se Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive.

Sigurimi i Ofertës për një Ofertë të dorëzuar nga një bashkim operatorësh do të jetë në përputhje me nenin 25 të Vendimit nr. 575 datë 10.07.2013 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave për Vlerësimin dhe Dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat” të ndryshuar.

**3.2.4** Me kërkesë të Ofertuesit jofitues, Autoriteti Kontraktues do t'i kthejë atij Sigurimin e Ofertës, kur është kërkuar, sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës apo çdo zgjatje të afatit të saj.

**3.2.5** Sigurimi i ofertës, i Ofertuesit Fitues, kur është kërkuar, do t'i kthehet atij, pasi ai të ketë dorëzuar Sigurimin e Kontratës pranë Autoritetit Kontraktues.

**3.2.6** Sigurimi i ofertës mund të mbahet nga Autoriteti Kontraktues, kur është kërkuar, në rastet kur Ofertuesi:

i) tërheq ofertën e tij gjatë procedurës konkurruese pa mbaruar afati i vlefshmërisë së ofertës;

ii) nuk paraqet Sigurimin e Kontratës (në rast se shpallet fitues);

iii) nuk nënshkruan kontratën koncesionare (në rast se shpallet fitues) brenda afateve kohore të specifikuara në Formularin e Njoftimit të Fituesit (Shtojca 16);

iv) ka deklaruar të dhëna të rreme në ofertën e tij;

v) në rast se shpallet fitues dhe e refuzon pagesën e shpenzimeve sipas pikës 1.4 më sipër.

**3.3 Prokura:** Çdo Ofertues (ose çdo anëtar i Bashkimit të Përkohshëm, kur Ofertuesi është i tillë) duhet të dorëzojë një prokurë noteriale, në formën e përcaktuar në Shtojcën 22, që tregon se personi (personat) që kanë nënshkruar Ofertën kanë të drejtën e nënshkrimit të saj.

### **3.4 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës:**

Ofertat duhet të jenë të vlefshme për 150 ditë duke filluar nga momenti i përfundimit të “afatit kohor për dorëzimin e ofertave”. Një ofertë me një vlefshmëri më të shkurtër se afati i përcaktuar do të refuzohet nga Komisioni i Dhënies me Koncesion si e papranueshme.

Në mënyrë përjashtimore, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga Ofertuesi zgjatjen e Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertës. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues dhe përgjigja e Ofertuesit duhet të jenë në formë të shkruar. Ofertuesi që pranon të zgjasë Periudhën e Vlefshmërisë së Ofertës dhe të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktor, do të zgjasë afatin e Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertës dhe do të dorëzojë një Sigurim të Zgjatur të Ofertës. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk zgjat periudhën e vlefshmërisë, apo nuk paraqet një Sigurim të Zgjatur të Ofertës, atëherë do të konsiderohet që Ofertuesi ka refuzuar kërkesën e Autoritetit Kontraktor.

Në rast të zgjatjes së Afatit të Vlefshmërisë së Ofertës, edhe afati i Sigurimit të ofertës, nëse është kërkuar, do të zgjatet në përputhje me pikën 3.2.2.

### **3.5 Formati dhe nënshkrimi i Ofertës**

**3.5.1** Çdo ofertues duhet të përgatisë dhe dorëzojë ofertën në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP). Informacione të detajuara lidhur me ngarkimin e ofertës gjenden në manualin e përdorimit, i cili është publikuar në adresën <https://www.app.gov.al>.

**3.5.2** Ofertuesi, i cili do të shpallet fitues i konkurrimit, do të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues ofertën origjinale. Oferta origjinale duhet të jetë e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi ose personat me të drejtë nënshkrimi (të autorizuar me prokurën e dorëzuar si pjesë e Ofertës Teknike, në përputhje me pikën 3.3 duhet të nënshkruajnë Ofertën duke:

i) Nënshkruar origjinalin e ofertës;

dhe

ii) Shënuar inicialet në secilën faqe të origjinalit të dokumenteve që shoqërojnë ofertën ekonomike.

**3.5.3** Oferta nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim të rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të ofertës. Oferta origjinale duhet të jetë identike me ofertën e ngarkuar në faqen e internetit të APP.

## **4. DORËZIMI I OFERTËS ORIGJINALE**

### **4.1 Format i dhe nënshkrimi i ofertës**

**4.1.1.** Në zbatim të VKM Nr. 130, date 12.3.2014 “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat” dhe VKM Nr. 575 datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat” i ndryshuar, oferta do të dorëzohet në format elektronik në përputhje me udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik. Një informacion më të qartë të kësaj procedure do të gjeni në faqen zyrtare [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

**4.1.2** Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj çdo Ofertuesi, ndaj çdo pretendimi apo ankese mbi paqartësi në mënyrën e dorëzimit të Ofertës me përjashtim të rastit kur një ofertë nuk sigurohet në mënyrën e duhur për shkak të mungesës së infrastrukturës së duhur nga ana e Autoritetit Kontraktor.

**4.1.3** Në çdo rast, Ofertuesit duhet të dorëzojnë në formë elektronike të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm si dhe të nevojshëm për prezantimin e ofertës së tyre.

**4.1.4** Ofertuesi i shpallur fitues duhet të dorëzojë ofertën origjinale pranë Autoritetit Kontraktues. Oferta origjinale duhet të vendoset në një zarf/kuti, të jetë e mbyllur dhe e vulosur. Mbi zarf/kuti duhet të jetë pasqyruar emri dhe adresa e ofertuesit si dhe shënimi:

Ofertë për projektin “Për dhënien me koncesion për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Milot-Balldre”.

Oferta origjinale duhet të dorëzohet në adresën e mëposhtme:

|              |                                                       |
|--------------|-------------------------------------------------------|
| Drejtuar:    | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë             |
| Në vemëndje: | Komisioni i Dhënies së Koncesionit/PPP                |
| Adresa:      | Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 1001, Tiranë Shqipëri |

Me dorëzimin e Ofertës konsiderohet se Ofertuesi bie dakord dhe e çliron Autoritetin Kontraktor, punonjësit e tij, agentët dhe këshilltarët në mënyrë të pakthyeshme, të pakushtëzuar, plotësisht dhe përfundimisht nga çdo detyrim për pretendime, humbje, dëme, kosto, shpenzime ose përgjegjësi që lidhen ose lindin në ndonjë mënyrë nga ushtrimi i çdo të drejte dhe/ose përmbushja e çdo detyrimi në këtë dokument, në bazë të dhe/ose në lidhje me sa më poshtë, dhe heq dorë nga çdo e drejtë dhe/ose pretendim që mund të lidhet me këtë aspekt, qoftë i parashikueshëm ose i paparashikuar, apo aktual ose i ardhshëm.

Autoriteti Kontraktor nuk lejon dorëzimin e ofertave alternative nga i njëjti Ofertues.

## **4.2 Afati për dorëzimin e Ofertave**

**4.2.1** Ofertat duhet të dorëzohen në faqen e internetit të APP brenda datës 02.10.2025, ora 12:00. Ofertuesi i shpallur fitues do të njoftohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues për afatin e dorëzimit të ofertës origjinale.

## **5. HAPJA DHE VLERËSIMI I OFERTAVE**

### **5.1 Hapja e Ofertave**

**5.1.1** Komisioni i Dhënies me Koncesion bën identifikimin e ofertuesve dhe hapjen e ofertave të dorëzuara në faqen e internetit të APP pas mbarimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

## **5.2 Vlerësimi i Ofertave**

**5.2.1** Pas hapjes së ofertës Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do t'a shqyrtojë atë për të përcaktuar nëse oferta është e pranueshme, nëse dokumentacioni i kërkuar është dorëzuar, nëse dokumentacioni i kërkuar për tu nënshkruar nga ofertuesi është nënshkruar rregullisht, dhe nëse Oferta është e rregullt.

**5.2.2** Vlerësimi i Autoritetit kontraktues do të bazohet në të dhënat dhe vetë përmbajtjen e Ofertës duke mos iu drejtuar burimeve të tjera. Megjithatë, nëse është e nevojshme, Komisioni i Dhënies së Koncesionit mund të kërkojë sqarime nga Ofertuesit, të cilat nuk përbëjnë një ndryshim të thelbit të Ofertës. Sqarimet duhet të jenë vetëm me shkrim ose/dhe të reflektuara në procesverbalin përkatës. Gjithashtu në raste të veçanta Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e tij për të përfshirë edhe ekspertë të ndryshëm, të cilët mund të ndihmojnë në trajtimin e atyre çështjeve për të cilat Komisioni i Dhënies me Koncesion has vështirësi.

### **5.2.3. Oferta do të konsiderohet e pavlefshme nëse:**

- i) ofertuesi nuk ka dorëzuar Sigurimin e Ofertës,
- ii) oferta përmban të dhëna të rreme;
- iii) nuk ka plotësuar një ose të gjitha kërkesat e ftesës për procedurën konkurruese.

**5.2.4** Komisioni i Dhënies së Koncesionit vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e procedurës përzgjedhëse, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

**5.2.5** Nëse më shumë se një ofertë financiare ka të njëjtën vlerë ose ka pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve.

**5.2.6** Komisioni i Dhënies së Koncesionit harton klasifikimin përfundimtar, i cili duhet të njoftohet publikisht dhe t'i komunikohet Ofertuesve. Pas njoftimit të klasifikimit përfundimtar, çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të përzgjedhjes, kur gjykon se një veprim i ndërmarrë nga Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni i Dhënies së Koncesionit është në kundërshtim me parashikimet e Ligjit Nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar dhe VKM nr.575, datë 10.7.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritetin publik privat", i ndryshuar, duke përdorur formularin e Ankimit të Procedurës Konkurruese, të përcaktuar në Shtojcën 21.

**5.2.7** Me mbarimin e procedurës ankimore Komisioni i Dhënies së Koncesionit përgatit raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe i propozon Kryetarit të Autoritetit Kontraktues, rezultatet e arritura për secilin prej ofertuesve.

## **5.3 Pavlefshmëria dhe Mossuksesi i Procedurës Konkurruese**

Procedura konkurruese quhet e pasuksesshme kur:

- i) Asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përmbush kërkesat e ftesës për procedurë konkurruese;

- ii) Autoriteti kontraktues, për mungesë të leverdisë ekonomike të ofertave ose të vetë projektit, shpall mbylljen e procedurës konkurruese;
- iii) Ose kur nuk ka pjesëmarrës në garë.

#### **5.4 Veprimet e kundraligjshme**

Në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit, dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktues e refuzon një ofertë, nëse Ofertuesi që e ka paraqitur atë:

- i) i ka dhënë ose përgatitet t'i japë një punonjësi aktual ose të mëparshëm të Autoritetit Kontraktues një dhuratë në para ose jo, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim, ose rrjedhën e procedurës së konkurrimit; dhe/ose është në kushtet e konfliktit të interesit në këtë procedurë, si psh – një ofertues është i lidhur me një person fizik ose juridik, që është ngarkuar nga Autoriteti Kontraktues të japë shërbime këshilluese gjatë përgatitjes së projekteve, specifikimeve ose dokumentave të tjerë lidhur me procedurën konkurruese, apo ka lidhje me anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
- ii) Ka dorëzuar dokumenta/informacione të rreme, që lidhen me kërkesat e paraqitura në Dokumentet Standarte të Procedurës Konkurruese.

Autoriteti Kontraktues e informon me shkrim ofertuesin dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për refuzimin e ofertës, si dhe për arsyet e këtij refuzimi, dhe bën shënimin përkatës në raportin për procedurën e konkurrimit.

#### **5.5 Përcaktimi i Ofertuesit Fitues dhe Nënshkrimi i Kontratës**

- 5.5.1** Pas përfundimit të afatit të ankimimit, të përcaktuar në pikën 5.2.6, Autoriteti Kontraktues informon Ofertuesin, oferta e të cilit është përzgjedhur si më e mira, përmes dërgimit të Njoftimit të Fituesit, siç parashikohet në Formularin e Njoftimit të Fituesit. Një kopje e zgjeruar e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike. Gjatë nënshkrimit, Autoriteti Kontraktues i kërkon Ofertuesit Fitues paraqitjen e Sigurimit të Kontratës.

Ofertuesi i përzgjedhur fitues sipas parashikimeve në ligjin nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues, Sigurimin e Kontratës 5 % (pesë përqind) të Vlerës së ndërtimit, ndërsa pas periudhës së ndërtimit do të jetë deri në 5% (pesë përqind) të vlerës së mbetur të kontratës, siç parashikohet në nenin 28 të Ligjit Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

Formulari i Sigurimit të Kontratës, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet sipas pikës 5.5.3.

Sigurimi i Kontratës mund të dorëzohet në formën e një:

- i) garancie bankare e pakushtëzuar  
ose
- ii) nëpërmjet një police sigurimi.

- 5.5.2** Autoriteti Kontraktues dhe Ofertuesi Fitues do të negociojnë në mirëbesim kushtet dhe afatet përfundimtare të Kontratës Koncesionare/Partneritetit Publik Privat, duke pasur parasysh se Ofertuesi Fitues do të kërkohet të nënshkruajë Kontratën Koncesionare sipas Kushteve të Veçanta dhe të Përgjithshme të Kontratës të nënshkruara nga ai në çdo faqe

dhe të dorëzuar si pjesë e Ofertës Teknike, të ndryshuara (nëse është e aplikueshme) gjatë procesit të negocimit të Kontratës Koncesionare/Partneritetit Publik Privat.

- 5.5.3** Nëse brenda një afati kohor \_\_\_\_\_ nga data e Njoftimit të Fituesit dhe afatit të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave bëhet e qartë se, nëse Ofertuesi Fitues (për arsye të pajustificuara) nuk do të dorëzojë Sigurimin e Kontratës dhe/ose nuk do të nënshkruajë Kushtet e Veçanta dhe të Përgjithshme të Kontratës, Autoriteti Kontraktues do t'i mbajë Ofertuesit Fitues, Sigurimin e Ofertës, nëse është kërkuar, dhe do të ftojë Ofertuesit e tjerë, sipas radhës në klasifikimin përfundimtar, deri sa të marrë Sigurimin e Kontratës dhe Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të nënshkruara në çdo faqe nga Ofertuesit sipas radhës, apo të refuzojë të gjitha Ofertat e mbetura.
- 5.5.4** Autoriteti Kontraktues do të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e Koncesionarit dhe termat kryesore të Kontratës Koncesionare, brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

## Shtojca 1

### FORMULARI I OFERTËS

[ Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik]

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

\* \* \*

Procedura e koncesionit/partneritetit publik privat: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

Vlera e Totale e parashikuar për Kontratën është \_\_\_\_\_ EUR pa TVSH.

Në këtë vlerë përfshihen shuma e Vlerës së Projektimit, Vlerës së ndërtimit/rehabilitimit, Vlerës së Operimit, Vlerës së Mirëmbajtjes rutinë dhe kapitale.

- Vlera e parashikuar e Projektit (projektimi) është \_\_\_\_\_ EUR pa TVSH

- Vlera e Ndërtimit/Rehabilitimit është \_\_\_\_\_ EUR pa TVSH

- Vlera e sitemit të pagesës Sistemi i Pagesës (toll) është \_\_\_\_\_ EUR pa TVSH

- Vlera e parashikuar e Operimit është \_\_\_\_\_ EUR pa TVSH

- Vlera e parashikuar e Mirëmbajtje Rutinë dhe Kapitale është \_\_\_\_\_ EUR pa TVSH

- Fondi Rezervë \_\_\_\_\_ EUR pa TVSH

Forma e paraqitjes së ofertës përcaktohet si më poshtë:

| a/a | KRITERE TEKNIKE                                                | Referencë / |
|-----|----------------------------------------------------------------|-------------|
| (1) | <b>Propozim Teknik për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës</b> |             |
|     | a. Projekt – Ide Konceptuale                                   |             |
|     | b. Metodologjia e punimeve                                     |             |
|     | c. Plani Operacional i mirëmbajtjes dhe disponueshmërisë       |             |
|     | d. Mbrojtja e shëndetit dhe jetës                              |             |
| (2) | <b>Ndikimi mjedisor</b>                                        |             |
| (3) | <b>Ndikimi social</b>                                          |             |
| (4) | <b>Afati për Përfundimin e Punimeve</b>                        |             |
|     | a. Milot - Balldre                                             |             |

| a/a | KRITERE FINANCIARE                                                                                                                    | Vlera e ofertuar |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| (1) | Tarifa Toll /km/pcu                                                                                                                   |                  |
| (2) | Garancia – niveli bazë (nën nivelin e të ardhurave bazë – Shteti nga viti i parë i operimit deri në maksimumi vitin e 17 të operimit) |                  |

|     |                                                                                                                        |  |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|     |                                                                                                                        |  |
| (3) | Shuma maksimale e kërkuar e garancisë (nga viti i parë i operimit deri në maksimumi vitin e 17 të operimit)            |  |
| (4) | Shpërblimi – niveli bazë (nën nivelin e të ardhurave bazë – Shteti përgjatë gjithë periudhës së koncesionit - vjetore) |  |
| (5) | Përqindja e shpërblimit                                                                                                |  |

Deklarojmë që pranojmë kushtet e projekt-Kontratës së Koncesionit.

**Shënim:** Specifikoni kohën e dorëzimit të Projekt Zbatimit

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula

Shënim:

Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

## Shtojca 2

(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti kontraktor)

### FTESA PËR OFERTË<sup>1</sup>

(shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor)

fton për të paraqitur oferta për kryerjen e Puneve të mëposhtme:

.....  
.....  
.....  
.....

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasive siç përkufizohet në Dokumentacionit Standart të Koncesioneve dhe partneritetit publik privat (DSK/PPP)).

Vendi i kryerjes së kontratës së punës

(jepni një përshkrim të shkurtër)

Afati i ekzekutimit të kontratës \_\_\_\_\_

Oferta duhet të paraqitet

.....

[Jep adresën e saktë]

Përpara

.....

[Percaktoni datën dhe kohen e afatit përfundimtar]

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

---

<sup>1</sup> Kjo shtojcë është e aplikueshme për procedurën e kufizuar dhe procedurën me negociim me shpallje paraprake

### Shtojca 3

[Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

[ Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik, kur kërkohet nga autoriteti kontraktor]

#### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e koncesionit/partneritetit publik privat [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm [] ditë, nga data e mbarimit të afatit të dorëzimit të ofertave në faqen e internetit të APP-së.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

## Shtojca 4

### LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Operatori Ekonomik]

(Shënoni më poshtë informacinin që dëshironi të mbahet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial | Numri i faqes dhe pikat e DSK/PPP që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial |
|---------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|
|                                                               |                                                                        |                                                        |                                                      |
|                                                               |                                                                        |                                                        |                                                      |
|                                                               |                                                                        |                                                        |                                                      |
|                                                               |                                                                        |                                                        |                                                      |
|                                                               |                                                                        |                                                        |                                                      |

Shënim: Çdo ofertues (ose anëtar i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, kur ofertuesi është i tillë) duhet të dorëzojë këtë shtojcë.

## Shtojca 5

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATË E PËRMBUSHJES SË KËRKESAVE TË DOKUMENTAVE STANDARTE TË KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_

Une i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të percaktuara në dokumentat e Koncesionit/ Partneritetit publik Privat dhe i pranojmë pa rezerva dhe asnjë vërejtje ato. Deklarojmë nën përgjegjësinë tonë ligjore se jemi dakord me të gjitha specifikimet teknike të dhëna dhe i plotësojmë ato sipas përcaktimit në dokumentat e Koncesionit/Partneritetit publik Privat. Ne përmbushim të gjitha kërkesat ligjore, financiaro-ekonomike si dhe specifikimet teknike të percaktuara në dokumentat standarte të procedurës konkurruese, dhe e vërtetojmë këtë me certifikata dhe dokumenta, të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë.

Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në dokumentat standarte për procedurën konkurruese.

Nuk do të marrim pjesë si ofertues në më shumë se një ofertë për këtë procedurë konkurruese.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin/ dokumentat që i bashkëlidhën kësaj oferte.

Në rast se oferta jonë pranohet në do të bëjmë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat standarte të procedurës konkurruese.

Në rast se shpallemi fitues të procedurës konkurruese, biem dakord për të nënshkruar Kontratën sipas formularit të kushteve të kontratës.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

Shënim: Çdo ofertues (ose anëtar i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, kur ofertuesi është i tillë) duhet të dorëzojë këtë shtojcë

## Shtojca 6

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATË** **Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se: Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet/partneritetin publik privat”.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula**

Shënim: Çdo ofertues (ose anëtar i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, kur ofertuesi është i tillë) duhet të dorëzojë këtë shtojcë

## Shtojca 7

[ Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik]

### FORMULAR VLERËSIMI ( Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

|                                                                                                   |                              |  |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------|--|
| Autoriteti kontraktor/Investitori                                                                 |                              |  |
| Adresa/Tel.                                                                                       |                              |  |
| Emri i Titullarit/Administratorit                                                                 |                              |  |
| <b>VËRTETOJ SE:</b>                                                                               |                              |  |
| Autoriteti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me                                      |                              |  |
| Emri i operatorit NIPT/<br><br>Bashkimit të operatorëve NIPDET/<br><br>Nënkontraktorët NIPDET     |                              |  |
| Adresa/t                                                                                          |                              |  |
| Objekti i kontratës:                                                                              |                              |  |
| Data e fillimit të kontratës                                                                      | Data e mbarimit të kontratës |  |
| Vlera sipas kontratës                                                                             | Vlera e realizuar            |  |
| % e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar<br><br>Nënkontraktorët. |                              |  |
| Vlerësimi                                                                                         | (shprehur me fjalë)          |  |
|                                                                                                   | E përmbushur                 |  |
|                                                                                                   | E papërmbushur               |  |
| <b>Firma</b>                                                                                      |                              |  |
| <b>Vula e Autoritetit Kontraktor</b>                                                              |                              |  |

## Shtojca 8

[ Shtojcë per tu plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik:\_\_\_\_\_

**Deklaroj se zotëron mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt:\_\_\_\_\_**

| Në pronësi     |       |                       |             |          |
|----------------|-------|-----------------------|-------------|----------|
| Lloji i Mjetit | Targa | Nr. Lejes qarkullimit | Nr. Shasisë | Të tjera |
| 1              |       |                       |             |          |
| 2              |       |                       |             |          |
| 3              |       |                       |             |          |
| 4              |       |                       |             |          |
| 5              |       |                       |             |          |

Dhe

| Me qera        |                |                                 |                       |                               |                                                         |
|----------------|----------------|---------------------------------|-----------------------|-------------------------------|---------------------------------------------------------|
| Lloji i Mjetit | Targa e mjetit | Nr. Lejes qarkullimit të mjetit | Nr. Shasisë së mjetit | Nr. Kont së qerasë (noterisë) | Afati i kontratës Qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit) |
| 1              |                |                                 |                       |                               |                                                         |
| 2              |                |                                 |                       |                               |                                                         |
| 3              |                |                                 |                       |                               |                                                         |
| 4              |                |                                 |                       |                               |                                                         |
| 5              |                |                                 |                       |                               |                                                         |
| 6              |                |                                 |                       |                               |                                                         |

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

### PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nenshkrimi Vula

## Shtojca 9

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
  - a) nuk është në proces falimentimi,
  - b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 76 të LPP,
  - c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 10 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
  - a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
  - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionale ose tregtare të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomik është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posacme.

### 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Sigurimi i ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b) Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- c) Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;
- d) Përshkrimi i Ofertës i plotësuar dhe nënshkruar në mënyrë të duhur, sipas Shtojcës 1;

- e) Formular vlerësimi sipas Shtojcës 7;
- f) Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 8.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë:**

Dokumentet ligjore dhe informacioni i shoqërisë që kërkohen janë si më poshtë:

- i. Një ekstrakt i lëshuar nga Regjistri Tregtar, Gjykata së cilës i është akorduar kompetenca për zgjidhjen e çështjeve tregtare, ose ndonjë autoritet tjetër kompetent publik në juridiksionin e ofertuesit, që dëshmon regjistrimin e këtij të fundit si subjekt ligjor dhe ka statusin aktiv;
- ii. Një vërtetim i lëshuar nga autoriteti kompetent publik që vepron në juridiksionin e ofertuesit, përmes së cilit konfirmohet se ky i fundit nuk është në proces falimentimi;
- iii. Një vërtetim i lëshuar nga autoriteti kompetent në juridiksionin e ofertuesit, përmes së cilit vërtetohet se ofertuesi (si dhe aksionari/ortaku, administratori, përfaqësuesi i ofertuesit) nuk është dënuar për shkelje penale;
- iv. Një vërtetim i lëshuar nga autoriteti kompetent që vepron në juridiksionin e ofertuesit përmes së cilit vërtetohet se ky i fundit nuk është dënuar për vepra që lidhen me veprimtarinë e tij profesionale;
- v. Një vërtetim i lëshuar nga autoriteti kompetent që vepron në juridiksionin e ofertuesit, përmes së cilit vërtetohet se kapitali dhe asetet e ofertuesit nuk janë subjekt i një urdhri ekzekutimi përmbarimor;
- vi. Një vërtetim i lëshuar nga autoriteti kompetent që vepron në juridiksionin e ofertuesit, përmes së cilit vërtetohet se ky i fundit nuk është në ndjekje penale;
- vii. Një vërtetim i lëshuar nga autoriteti kompetent publik që vepron në juridiksionin e ofertuesit (d.m.th. autoriteti i tatimeve), përmes së cilit vërtetohet se ky i fundit i ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore;
- viii. Një dokument që pasqyron strukturën organizative ekzistuese të ofertuesit.
- ix. Ofertuesi nuk duhet të jetë listuar si një subjekt që nuk mund ta zhvillojë veprimtarinë e tij tregtare në Shqipëri ose shtetet e BE-së dhe nuk duhet të jetë i përfshirë në listat e zezë të Institucioneve Ndërkombëtare Financiare (INF).
- x. Ofertuesi nuk duhet të jetë i përfshirë në ndonjë nga listat e OKB-së për personat që dyshohen se janë përfshirë në aktivitete terroriste ose në listat e tjera të zezë kombëtare e ndërkombëtare.
- xi. Ofertuesi dhe ndonjë aksionar në zinxhirin e tij të pronësisë, përfshirë edhe pronarin e fundit përfitues, ose ndonjë nga filialet apo principalet e tij, nuk duhet të banojnë, të kenë aktivitete dhe nuk duhet të zhvillojnë tregti me ose të kenë lidhje me vendet që kanë embargo nga Zyra për Kontrollin e Pasurive të Huaja (OFAC) ose janë subjekt i sanksioneve të BE-së ose OKB-së; ose është në vendin që është i përfshirë në listën e zezë të BE-së.
- xii. Në rast se ofertuesi është i huaj (pra është një shoqëri e regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë), ai duhet të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara më sipër. Në rast se dokumentet e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e origjinës të ofertuesit, atëherë ato do të pranohen në formën e vetdeklaratës me shkrim, nën përgjegjësinë e ofertuesit (sipas formës së paraqitur në Shtojcën 12). Lidhur me deklarin e mos lëshimit të këtyre vërtetimeve nga institucione të shtetit të origjinës, ofertuesit duhet të paraqesin vërtetim nga Dhoma e Tregtisë së vendit të origjinës - duke evidentuar faktin se ndonjë apo të gjitha vërtetimet e kërkuara në këtë Shtojcë 9, nuk lëshohen nga ndonjë institucion publik përgjegjës.

Dokumentet e lëshuara/përgatitura në gjuhën shqipe nuk duhen shoqëruar në gjuhën angleze ndërsa dokumentat e lëshuara/përgatitura në gjuhë të huaj (përveç gjuhës angleze), duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Të gjitha dokumentet e dorëzuara nga Ofertuesit duhet të jenë origjinale ose kopje të njehësura me origjinalin nga një noter publik dhe të lëshuara nga autoritetet publike jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës. Dokumentet e lëshuara nga autoritetet publike në juridiksione të tjera dhe dokumentet e certifikuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës së datës 05.10.1961 për vulën Apostile.

Çdo ofertues (ose anëtar i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, kur ofertuesi është i tillë) duhet të dorëzojë dokumentet e përcaktuara më lart.

Gjithashtu, në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, dokumentet që duhet të dorëzohen janë si më poshtë:

- a) Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës është krijuar zyrtarisht Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive.
- b) Prokura e veçantë.
- c) Vendimi i palëve vendimmarrëse të shoqërisë ose të bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive dhe /ose partneritetit.

Në rastin e një partneriteti, informacionet kryesore për Ofertuesin (ose secilin anëtar të një Partneriteti), Ofertuesi duhet të dorëzojë një deklaratë përfshirë edhe listën e përditësuar të aksionarëve dhe informacionet për përfituesit e fundit të Ofertuesit, të cilët zotërojnë ose kontrollojnë një shoqëri dhe/ose personat fizikë në emër të të cilëve po kryhet transaksioni ose po zhvillohet projekti, dhe/ose ata persona, të cilët kanë kontroll efektiv mbi një person ligjor ose marrëveshje, kanë interes të konsiderueshëm në ose marrin përfitime të konsiderueshme ekonomike nga një shoqëri. Në këtë informacion duhet të përfshihen në veçanti individët, të cilët plotësojnë një ose më shumë nga pesë kushtet e mëposhtme:

- i. zotërojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë më tepër se 10% të aksioneve të Ofertuesit;
- ii. zotërojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë më tepër se 10% të të drejtave votuese të Ofertuesit;
- iii. zotërojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të drejtën për të emëruar ose shkarkuar pjesën më të madhe të drejtorëve të Ofertuesit;
- iv. kanë të drejtën për të ushtruar ose ushtrojnë aktualisht ndikim ose kontroll të konsiderueshëm mbi Ofertuesin; dhe/ose
- v. kur një trust ose firmë do të plotësonte një nga katër kushtet e para, në rast se do të ishte individ, çdo individ që ka të drejtën për të ushtruar ose ushtron aktualisht ndikim ose kontroll të konsiderueshëm mbi aktivitetet e atij trusti ose firme.

Në informacionin për secilin nga pronarët përfitues, duhet të përfshihet sa më poshtë:

- (i) emri i plotë i tanishëm ose të gjithë emrat e mëparshëm.
- (ii) kombësia dhe numri i identitetit kombëtar.
- (iii) vendi i banimit.
- (iv) data dhe vendi i lindjes.
- (v) niveli i pronësisë përfituese; dhe

(vi) detaje për mënyrën se si përdoret pronësia, kontrolli ose interesat ekonomikë. Në rast se këto detaje janë dokumentuar në një regjistër të qendëruar për pronësinë përfituese në vendin e regjistrimit, kjo kërkesë mund të plotësohet nga aplikimi duke iu referuar dhe duke bashkëngjitur këto dokumentime.

Secili nga anëtarët e Bashkimit të Shoqërive duhet të vërë në dispozicion informacionet për pronësinë përfituese. Ofertuesi do të njoftojë me shkrim Komisionin e Dhënies së Koncesionit, sa më shpejt të jetë e mundur, për çdo ndryshim material, përfshirë ndryshimet që kanë ndodhur në pronësinë përfituese krahasuar me raportimet e mëparshme.

**Gjithashtu, çdo Ofertues (ose anëtar i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, kur ofertuesi është i tillë) duhet të dorëzojë:**

1. Dokument që vërteton se kapitalet/asetet e subjektit tuaj nuk janë në duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit në qytetin ku keni selinë tuaj qendrore;
2. Vërtetim i lëshuar nga autoriteti kompetent publik që vepron në juridiksionin e ofertuesit, përmes së cilit konfirmohet se ky i fundit nuk është në proces falimentimi;
3. Dokument që vërteton se ofertuesi i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga Administrata Tatimore;
4. Dokument që vërteton se ofertuesi i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Administrata Tatimore;
5. Një dokument që vërteton strukturën ekzistuese organizative të ofertuesit.
6. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka Ofertuesi që është i regjistruar në Shqipëri. Mosdorëzimi i vërtetimit për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, përbën shkak për skualifikimin e Ofertuesit. Në rast se në përmbajtjen e vërtetimit rezulton se ekzistojnë detyrime të pashlyera ndaj furnizuesit të energjisë elektrike, kjo përbën gjithashtu shkak për skualifikim, përveç rasteve kur në vërtetim konfirmohet se këto detyrime janë objekt i një procesi ankimi gjyqësor në një gjykatë kompetente.  
Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar të lëshojë vërtetimin e kërkuar brenda një afati maksimal prej **5 (pesë) ditësh kalendarike** nga data e depozitimit të kërkesës nga Ofertuesi.

Kriteret e mësipërme përmbushen vetëm nëse dokumentet e paraqitura janë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Shoqëritë ofertuese duhet të jenë të regjistruara në regjistrat përkatës profesionale ose tregtarë të shtetit në të cilin ato janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor. Për këtë ofertuesit duhet të dorëzojnë **Ekstraktin mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.**

Ofertuesi i huaj (shoqëri e regjistruar jashtë territorit të Shqipërisë) duhet të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur në pikat përkatëse nuk lëshohen në shtetin e origjinës të ofertuesit, atëherë ato do të pranohen në formë deklarates me shkrim, nën përgjegjësinë e ofertuesit (sipas formës së paraqitur në Shtojcën 12). Lidhur me deklarin e mos lëshimit të këtyre vërtetimeve nga institucione të shtetit të origjinës, ofertuesit duhet të paraqesin vërtetim nga Dhoma e Tregtisë së vendit të origjinës - duke evidentuar faktin se ndonjë apo të gjitha vërtetimet e kërkuara në këtë Shtojcë nuk lëshohen nga ndonjë institucion publik përgjegjës. Sipas rastit, Autoriteti Kontraktues mund të investigojë nëse këto vërtetime lëshohen apo jo nga institucionet përkatëse në vendin e origjinës, dhe në rast se konstaton

zyrtarisht se në shtetin e origjinës ekziston një institucion i cili mund të lëshoj një vërtetim/vertetime të tillë/tilla, të paraqitur nga ofertuesi i huaj në formën e vetë deklaramit atëherë Komisioni do të quaj të pavlefshëm dokumentin vetë deklarues të paraqitur.

### **Kërkesat e Shtojcës 9 janë të detyrueshme për çdo Ofertues (ose anëtar i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, kur ofertuesi është i tillë)**

Në rastet kur operatori ekonomik është anëtar i një shoqërie kontrolluese, ai mund ta përdorë kapacitetin financiar e teknik ose ndonjë nga anëtarët e tjerë të këtij të fundit, përmes një vendimi të marrë nga organet vendimmarrëse të parashikuara në statutin e tij. Kërkesat e përcaktuara në Shtojcën 9 duhet të përmbushen nga operatori pjesëmarrës ekonomik dhe nga anëtari i kompanisë kontrolluese, kapacitetet e të cilit do të përdorë operatori ekonomik.

Vendimi i marrë nga organi përkatës drejtues i shoqërisë/shoqërive do të përmbajë minimalisht:

- a) Konfirmimin për pjesëmarrjen në procedurën konkurruese dhe dorëzimin e ofertës financiare;
- b) Autorizim me pushtet të plotë për personin që kryen dorëzimin dhe nënshkrimin e ofertës.
- c) Kusht lidhur me zotimin për financim

Ofertuesit duhet të paraqesin dokumente që dëshmojnë një marrëveshjeje të besueshme dhe të verifikueshme financimi për projektin, duke specifikuar qartë vlerën e financimit. Këto dokumente mund të jenë në formën e një ose më shumë letrash interesi për mbështetjen “në parim” të projektit, të lëshuara nga institucione financiare me reputacion të mirë, ku shprehet qartë angazhimi i tyre për financimin e projektit; dhe/ose një autorizim/letër angazhimi nga Bordi i Shoqërisë, apo nga një autoritet vendimmarrës i ngjashëm në nivel të lartë të Ofertuesit, për financimin e projektit nga burime të brendshme; si dhe prova të fondeve të disponueshme, ose një kombinim i këtyre dokumenteve.

### **Legalizimi i dokumentacionit**

Dokumentet e siguruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të legalizuara në mënyrë që të kenë vlerë ligjore. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëritë që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës së Hagës (5 TETOR 1961) duhet të përmbajë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

### **Bashkimi i përkohshëm i shoqërive**

Operatorët ekonomikë mund të ofertojnë të vetëm ose të krijojnë grupe operatorësh ekonomikë dhe të ofertojnë si një kandidat i vetëm.

Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit ose e punës që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

Përpara dorëzimit të ofertës, bashkimi i përkohshëm duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së secilit anëtar dhe elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi të përkohshëm. Vullneti për të hyrë në marrëveshje të bashkimit të përkohshëm të shoqërive duhet të jetë i shprehur qartë me vendim të organit vendimmarrës të të gjitha shoqërive pjesëmarrëse

në kontratën e bashkimit të përkohshëm. Për të vërtetuar së cili është organi vendimmarrës në këtë bashkim të përkohshëm shoqërisht, duhet të paraqitet statuti aktual i secilës prej shoqërive pjesëmarrëse në këtë bashkim të përkohshëm.

Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e grupit caktojnë, me prokurë, përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në procedurë në emër të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë.

Në rast se, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore në përputhje me nenin 25 të VKM nr. 575 datë 10.07.2013 “Mbi miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, të ndryshuar, dispozitave të parashikuara në legjislacionin në fuqi si dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet.

Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, i caktuar si përfaqësues i grupit dhe i propozuar nga anëtarët e tjerë jo përfaqësues, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën, përndryshe, autoriteti kontraktor mund të tërhiqet nga kontrata. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, nëse përfaqësuesi i grupit nuk cakton një zëvendësues, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i grupit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në rast se përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë falimenton, ose në rrethana të tjera, e ndërpret veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund ta vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, të përcaktuar si përfaqësuesi i grupit dhe i propozuar nga anëtarët e tjerë jo-përfaqësues, me kusht që ai të ketë kapacitet ligjor, ekonomik, financiar e teknik për ta zbatuar kontratën, në të kundërt, autoriteti kontraktor mund të tërhiqet nga kontrata. Në rast se në këto rrethana gjendet operatorit tjetër ekonomik, dhe në rast se përfaqësuesi i grupit nuk arrin të caktojë një zëvendësues, atëherë, detyrimet e operatorit ekonomik që dështoi do të merren përsipër nga përfaqësuesi ose anëtari tjetër i grupit, me kusht që ai ose ajo të përmbushë të gjitha kërkesat.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Ofertuesi duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të konkurrimit dhe mban përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në Kushtet e Përgjithshme dhe të veçanta të Kontratës.

2.2.1 Të gjithë Ofertuesit duhet të tregojnë një pozitë ekonomike e financiare që siguron financimin e zbatimit të qëllimit të Marrëveshjes së Konkensionit. Në mënyrë që një ofertues të

kualifikohet, ai duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a. Të dorëzojnë bilanci e tre viteve të fundit financiare ku të tregojnë se raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit në të paktën për dy bilance të njëpasnjëshme të jenë pozitive (>0).
- b. Kapitale të veta (totali i aktivitetit minus detyrimet) për vitin e fundit fiskal duhet të jenë jo më pak se 30% e vlerës të projektit siç tregohet në Pasqyrat Financiare të Audituar të vitit të fundit fiskal.
- c. Një xhiro mesatare vjetore të paktën 1 (një) nga 3 (tre) vite të fundit financiare (2022, 2023, 2024) minimalisht sa 10% e vlerës së kontratës.

2.2.2. Për qëllime të rasteve sipas 2.2.1 ofertuesi duhet të dorëzojë pasqyrat financiare të 3 (tre) viteve të fundit të cilat duhet të jenë:

- a. Të audituara nga auditues ligjor dhe të shoqëruara me shënime shpjeguese.
  - b. Të publikuara (vendos adresën e sistemit elektronik të faqes në të cilën janë publikuar pasqyrat financiare) në përputhje me Ligjin e Shtetit ku ofertuesi ka selinë e tij.
  - c. Në një nga monedhat e publikuara në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë
- Mosplotësimi i këtyre kërkesave përbën shkak për skualifikim të ofertuesit.

2.2.3. Ofertuesit duhet të paraqesin dokumente që dëshmojnë një marrëveshje të besueshme dhe të verifikueshme financiare për projektin, duke specifikuar qartë vlerën e financimit. Këto dokumente mund të jenë në formën e një ose më shumë letrash interesi për mbështetjen “në parim” të projektit, të lëshuara nga institucione financiare me reputacion të mirë, ku shprehet qartë angazhimi i tyre për financimin e projektit; dhe/ose një autorizim/letër angazhimi nga Bordi i Shoqërisë, apo nga një autoritet vendimmarrës i ngjashëm në nivel të lartë të Ofertuesit, për financimin e projektit nga burime të brendshme; si dhe prova të fondeve të disponueshme, ose një kombinim i këtyre dokumenteve.

2.2.4. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë plan biznesi për të gjithë periudhën e koncesionit/ppp duke përfshirë të dhënat e kërkuara në dokumentet e tenderit. **Plani i Biznesit duhet të hartohet në përputhje me pikat 3 e vijuese të nenit 7 të VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për Miratimin e Rregullave për Vlerësimin dhe Dhënien me Koncesion/ Partneritet Publik Privat” të ndryshuar për aq sa është e aplikueshme.**

## 2.3 Kapaciteti teknik:

Ofertuesi (ose çdo anëtar i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, kur ofertuesi është i tillë) duhet të plotësojë kërkesat teknike profesionale, si dhe duhet të zotërojë dhe demonstrojë në mënyrë të përmbledhur Eksperiencën referuar punës/shërbimeve që është angazhuar të kryejë.

Ofertuesi duhet të plotësojë Eksperiencën në Projektim, Ndërtim dhe Mirëmbajtje për Segmentin Rrugor Milot-Ballëdre, si dhe Kapacitetin Profesional në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

### 2.3.1. Eksperienca në Projektim

Ofertuesi, ose në rast se Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, anëtarët e tij që janë deklaruar si përgjegjës për realizimin e Projektimit, duhet që gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, për të vërtetuar se kanë përvojën e duhur në projektimin e natyrës së objektit që prokurohet duhet të vërtetojnë se plotësojnë sa më poshtë vijon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 10% e vlerës së përllogaritur të projektimit për objektin që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
  - kontratën dhe vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit;
  - situacionet dhe faturat tatimore të shitjes (për të gjithë vlerën e kontratës), të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
  - situacionet dhe fatura tatimore të shitjes (për të gjithë vlerën e kontratës) të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
  - kontratën dhe vërtetime për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit.

Ofertuesi, ose në rast se Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, anëtarët e tij që janë deklaruar si përgjegjës për realizimin e Projektimit, duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës bazuar në formatin e miratuar. Licenca profesionale e operatorëve ekonomikë e lidhur me ekzekutimin e shërbimeve të kontratës objekt prokurimi, duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Kategoria 2.d Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe
- Kategoria 4.i Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.
- Kategoria 4.j Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit të zjarrit etj.
- Kategoria 6.a Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- Kategoria 6.b Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.
- Kategoria 6.c Projektim Autostrada
- Kategoria 7.b Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.
- Kategoria 7.c Projektim ura/viadukte me hapësira të mëdha drite, ura të varura, ura me sistem të pacaktuar statikisht dhe sisteme të tjera speciale.
- Kategoria 7.e Projektim tunele rrugore-hekurudhore.

- Kategoria 8.a Rilevime Inxhinierike
- Kategoria 9.d Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- Kategoria 9.e Studime e projektme hidrogjeologjike.
- Kategoria 10.e Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm
- Kategoria 11.a Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.
- Kategoria 11.b Projektim sinjalistikë jondricuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.
- Kategoria 11.d Projektim sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.
- Kategoria 12.c Studime/ Vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

Bazuar në Vendimin nr. 943, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, subjektet fizike / juridikë të huaj duhet të aplikojnë për ekuivalentimin e licencës së huaj në Republikën e Shqipërisë.

Kandidati/ofertuesi i huaj duhet të bëjë njehsimin e licencave profesionale të lëshuara nga vendi i origjinës për kategoritë e punimeve pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në Republikën e Shqipërisë (mosparaqitja e saj përbën kusht skualifikues).

Ofertuesi, ose në rast se Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, anëtarët e tij që janë deklaruar si përgjegjës për realizimin e Projektimit, duhet të vërtetojë se disponojnë kualifikimet e duhura të stafit drejtues teknik të shoqërisë, të aftë për kryerjen e të gjitha shërbimeve sipas objektit të kësaj kontrate, si më poshtë:

- Drejtues projekti (Inxhinier Ndërtimi)
- Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist.
- Inxhinier Ndërtimi profili Infrastrukturë e Transportit
- Inxhinier Elektrik
- Inxhinier Elektronik
- Inxhinier Hidroteknik
- Inxhinier Mjedis
- Inxhinier Gjeoteknik
- Inxhinier Gjeodet/ Markshajder
- Inxhinier Gjeolog
- Inxhinier Mekanik

*Për secilin pjesëtar të stafit kryesor të mësipërm duhet të paraqesë: kontratë pune, CV dhe licencat profesionale për projektim për objektin që prokurohet.*

### 2.3.2. Eksperienca në ndërtim

Ofertuesi, ose në rast se Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, anëtarët e këtij Bashkimi që janë deklaruar përgjegjës për ndërtimin, për të vërtetuar se kanë përvojën e duhur në ndërtim, duhet të vërtetojnë se plotësojnë sa më poshtë:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 15% e vlerës së përlllogaritur për ndërtimin dhe sistemin e pagesës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

#### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

***Pika 2.3.2/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.*** Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë ***të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*** Kurse pika 2.3.2/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit ***në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 7, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore (për të gjithë vlerën e kontratës së sipërmarrjes), të deklaruara në organet tatimore ;
  - Aktin e kolaudimit;

**Shënim:** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Vërtetim i lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore (për të gjithë vlerën e kontratës së sipërmarrjes) të deklaruara në organet tatimore;
  - Akt kolaudimi objekti;

**Shënim:** *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Ofertuesi, ose në rast se Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, anëtarët e këtij Bashkimi që janë deklaruar përgjegjës për ndërtimin duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e

Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e ndryshuar. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

|    |          |                                                                                                           |
|----|----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1  | NP-1-G   | Punime gjurmimi në tokë                                                                                   |
| 2  | NP-2-B   | Ndërtime civile dhe industriale                                                                           |
| 3  | NP-4-G   | Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale                               |
| 4  | NP-5-G   | Punime nëntokësore, ura, vepra arti                                                                       |
| 6  | NP-9-E   | Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime                                           |
| 7  | NP-11-C  | Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë |
| 8  | NP-12-D  | Punimet të inxhinierisë së mjedisit                                                                       |
| 9  | NS.1 – D | Punime për prishjen e ndërtimeve                                                                          |
| 10 | NS-6- E  | Sinjalistika rrugore jondriçuese                                                                          |
| 11 | NS-7-F   | Barriera dhe mbrojtje rrugore                                                                             |
| 12 | NS-9 – D | Punime strukturorë speciale                                                                               |
| 13 | NS-18-E  | Punime topogjeodezike                                                                                     |
| 14 | NS-20-F  | Shpime gjeologjike-inxhinierike, puse e shpime për ujë                                                    |

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008 e ndryshuar). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Personelin kryesor **drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi, profili Strukturist**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Infrastrukturë e Transportit**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1(një) Inxhinier Elektrik**
- **1(një) Inxhinier Gjeolog**
- **1(një) Inxhinier Mjedisi**
- **1(një) Inxhinier Gjeodet/ Markshajder**
- **1(një) Inxhinier Mekanik**

*Për secilin pjesëtar të stafit kryesor të mësipërm duhet të paraqesë: CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Personelin mbështetës, si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi, profili Strukturist**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Infrastrukturë e Transportit**
- **1(një) Inxhinier Elektronik**
- **1(një) Inxhinier Gjeolog**
- **1 (një) Inxhinier Gjeoteknik**
- **1(një) Inxhinier Gjeodet/ Markshajder**
- **1(një) Inxhinier Mekanik**

*Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: kontratë pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Kujdes: Personat e deklaruar në stafin kryesor nuk mund të jenë njëkohësisht pjesë e stafit mbështetës, dhe anasjelltas.

Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 200 (dyqind) persona. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin **gusht 2025.**
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin **gusht 2025.**

Ofertuesi (zbatuesi i punimeve) duhet të paraqesë një kopje ose përkthim të planit të shoqërisë lidhur me Sigurimin e Cilësisë dhe Kontrollin e Cilësisë.

Ofertuesi (zbatuesi i punimeve) duhet të konfirmojë se vepron në përputhje me të gjitha kërkesat dhe standardet ISO. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me Standardet e mëposhtme :

*ISO 9001:2015      Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*

*ISO 14001:2015      Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*

*ISO 45001:2023      Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

*ISO 39001 - 2012      Menaxhimi i Sigurisë së Trafikut Rrugor*

*Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.*

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të Politikës së Përgjithshme të shoqërisë lidhur me Shëndetin, Sigurinë dhe Mjedisin (ShSM) si dhe të konfirmojë pajtueshmërinë e tyre me kërkesat e Certifikatës HSE OHSAS 18001:2007. Operatori ekonomik duhet të tregojë mënyrën se si është respektuar Politika e Shoqërisë lidhur me ShSM gjatë 3 (tre) viteve të fundit, për sa i

përket aksidenteve, si dhe statistikën e incidenteve gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar.

*Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

### **Përkthimi**

Të gjitha dokumentet e siguruar nga subjektet publike jashtë Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara me vulën Apostile në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast se origjinali i këtij dokumenti është në një gjuhë tjetër, ai duhet të përkthehet në gjuhën shqipe, si dhe do të noterizohet nga një noter publik. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

### **Legalizimi i dokumentacionit**

Dokumentet e siguruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga subjektet e huaja ligjore duhet të legalizohen me qëllim për të pasur vlerë ligjore. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëritë e regjistruara në Shtetin e Konventës së Hagës duhet të kenë vulën Apostile në përputhje me Ligjin Nr. 9060, datë 08.05.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

## Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën koncensionit/ppp që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktues \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

Shënim: Çdo ofertues (ose anëtar i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, kur ofertuesi është i tillë) duhet të dorëzojë këtë shtojcë

## Shtojca 11

*[ Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]*

### **KRITERETE VLERESIMIT**

Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme, dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pikë më tepër në bazë të kriterëve të vlerësimit.

Komisioni i Dhënies së Koncesionit do të vlerësojë Ofertat Teknike dhe Financiare, në bazë të kriterëve të mëposhtme:

|                  |     | KRITERET TEKNIKE                                                        |                    |                             |                        |                                                  |                                    |                     |                                                                |
|------------------|-----|-------------------------------------------------------------------------|--------------------|-----------------------------|------------------------|--------------------------------------------------|------------------------------------|---------------------|----------------------------------------------------------------|
|                  | a/a | Kriteri                                                                 | Njësitë/s<br>henja | SHTET<br>I<br>Rasti<br>bazë | OFERT<br>UESI<br>Rasti | Pikëzimi i<br>vlerësimit                         | Pikëzimi<br>maksimal<br>/Graviteti | Rezultati i ofertës | Përshkrimi                                                     |
| Propozimi teknik | (1) | Propozimi teknik për ndërtimindhe mirëmbajtjen e rrugës (2)+(3)+(4)+(5) |                    |                             |                        |                                                  | 55                                 |                     |                                                                |
|                  | (2) | Projekt ide konceptuale                                                 | Ref. material      |                             |                        |                                                  | 30                                 |                     |                                                                |
|                  | (3) | Metodologjia e punimeve                                                 | Ref. material      |                             |                        |                                                  | 10                                 |                     |                                                                |
|                  | (4) | Plani operacional i mirëmbajtjes dhe disponueshmerise                   | Ref. material      |                             |                        |                                                  | 10                                 |                     |                                                                |
|                  | (5) | Mbrojtja e shëndetit dhe jetës                                          | Ref. material      |                             |                        |                                                  | 5                                  |                     |                                                                |
| Ndikimi          | (6) | Ndikimi mjedisor gjatë ndërtimit                                        | Ref. material      |                             |                        |                                                  | 10                                 |                     |                                                                |
|                  | (7) | Ndikimi social gjatë ndërtimit                                          | Ref. material      |                             |                        |                                                  | 5                                  |                     |                                                                |
| Afati            | (8) | Afati për përfundimin e punimeve (jo më shumë se 30 muaj)               |                    |                             |                        |                                                  | 30                                 |                     |                                                                |
|                  |     | a. Milot - Balldre                                                      | muaj               | 30                          |                        | (afati më i ulët i ofertuar/ afati i ofertuesit) | 30                                 |                     |                                                                |
|                  |     | FAKTOR TEKNIK (Y) :                                                     |                    |                             |                        |                                                  |                                    | SHUMA               | Formula_Y= Shumatorja e pikëzimeve (2)+(3)+(4)+(5)+(6)+(7)+(8) |

|                         |     | KRITERE FINANCIARE                                                                                                                        |                |                   |                 |         |                                                  |         |                      |                     |                                                                                                                        |
|-------------------------|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------|-----------------|---------|--------------------------------------------------|---------|----------------------|---------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Trafiku                 | a/a | Kriteri                                                                                                                                   | Njësitë/shenja | SHTETI Rasti bazë | OFERTE SI Rasti | Simboli | Dif. Në % = f(Ofertuesi, Shteti)                 | Simboli | Faktori i gravitetit | Rezultati i ofertës | Përshkrimi                                                                                                             |
| Të ardhurat nga trafiku | (1) | Trafiku mesatar i ponderuar /dite                                                                                                         | Automjet       | 41,023            |                 |         |                                                  |         |                      |                     | Mesatarja e ponderuar e mjeteve-jo në kohëzgjatjen e përgjithshme të projektit - viti i parë i operimit                |
|                         | (2) | Gjatësia e segmentit rrugor                                                                                                               | Km             | 17                |                 |         |                                                  |         |                      |                     | Gjatësia e autostradës së projektit                                                                                    |
|                         | (3) | Automjeti_Kilometër                                                                                                                       | Automjet_KM    | 697,391           |                 |         |                                                  |         |                      |                     | (3) = (1) x (2)                                                                                                        |
| Garacia                 | (4) | Vlera Toll/km/automjet                                                                                                                    | €              | 0.1200            |                 | a:      | (norma më e ulët e ofertuar/norma e ofruesit)    | b:      | 30                   | (a x b)             | Norma më e ulët e ofruar ndërmjet ofertuesve merr pikët më të mëdha, ku 0.1200eu/km është vlera maksimale              |
| Shpërbli mi i garancisë | (5) | Garanci – niveli fillestar (nën nivelin e të ardhurave bazë – shteti nga viti i parë i operimit deri në maksimumi vitin e 17 të operimit) | (në përqindje) |                   |                 | c:      | (% më e ulët e ofertuar / % ofertuesit)          | d:      | 20                   | (c x d)             | Nivelit bazë më i ulët i të ardhurave mbi të cilën llogaritet garancia ndërmjet ofertuesve merr pikët më të larta      |
|                         | (6) | Shuma e garancisë maksimale ( nga viti i parë i operimit deri në                                                                          | vlera (€)      | 25,376,569        |                 | e:      | (vlera më e ulët e ofertuar/ Vlera e ofertuesit) | f:      | 30                   | (e x f)             | garancia shtetërore nga viti i parë i operimit deri në maksimumi vitin e 17 të operimit) - vlera maksimale: 25,376,569 |

|                   |     |                                                                                                                     |                |             |  |            |                                                  |            |           |              |                                                                                         |
|-------------------|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------|--|------------|--------------------------------------------------|------------|-----------|--------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|
|                   |     | maksimumi vitin<br>17 të operimit)                                                                                  |                |             |  |            |                                                  |            |           |              |                                                                                         |
| <b>Shpërblimi</b> | (7) | Shpërblimi-niveli fillestar (nën nivelin e të ardhurave bazë – shteti – vjetore përgjatë periudhës së koncesionit ) | (në përqindje) | <b>0.0%</b> |  | <b>g:</b>  | (Vlera më e ulët e ofertuar/ Vlera e ofertuesit) | <b>h:</b>  | <b>10</b> | ( g x h)     | Ofertuesi me % më të ulët , % negative do të vlerësohet me më shumë pikë në këtë kriter |
|                   |     |                                                                                                                     |                |             |  |            |                                                  |            |           |              |                                                                                         |
|                   | (8) | Përqindja e shpërblimit                                                                                             | (+ )%          | <b>35%</b>  |  | <b>k :</b> | (% e Ofertuesit/ Maksimumi i % të ofertuar)      | <b>I :</b> | <b>10</b> | (k x i)      | Përqindja e shpërblimit ( $\geq 35\%$ deri në 100%)                                     |
|                   | (9) | <b>FAKTORI FINANCIAR (X) :</b>                                                                                      |                |             |  |            |                                                  |            |           | <b>SHUMA</b> | <b>Formula _X = (a x b)+(c x d) + (e x f) +(g x h) + (k x i)</b>                        |
|                   |     | <b>FAKTORI I TOTALIT TË PËRGJITHSHËM (Z) :</b>                                                                      |                |             |  |            |                                                  |            |           |              | <b>Formula _Z = 50% x (X) + 50% x (Y)</b>                                               |

Ofertat vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme dhe fitues do të konsiderohet ofertuesi që ka më shumë pikë bazuar në kriteret e vlerësimit. Komisioni i Dhënies së Koncesionit do t'i vlerësojë ofertat bazuar në kriteret e mëposhtme:

### **Shpjegimi i kriterëve të vlerësimit**

## **1. OFERTA TEKNIKE 100 (njëqind) PIKË - (për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve)**

### **1.1 Projekt ide konceptuale 30 (tridhjet) pikë**

Ofertuesi duhet të shtjellojë më tej projektin në bazë të rishikimit të të gjitha kërkesave kryesore të Autoritetit Kontraktor dhe përdorimit të rezultateve të vëzhgimeve dhe studimeve teknike në dispozicion brenda ose jashtë projektit.

Ofertuesi do të zhvillojë një projekt – ide konceptuale i cili do të përfshijë zërat e mëposhtëm:

- Përvijimi horizontal
  - Autostradë kategoria “A”
  - Rrugët e Shërbimit
  - Rruga alternative pa pagesë kategoria “C”, e cila duhet të ndodhet në një distancë rreth 1 km por jo më shumë se 1.5 km nga aksi kryesor i rrugës Milot-Balldre, në rast se ofertuesi zgjedh të përdorë rrugën ekzistuese. Në rast se ofertuesi zgjedh të ndërtojë një aks të ri jashtë aksit ekzistues, rruga ekzistuese mund të shfrytëzohet si rrugë alternative pa pagesë, duke respektuar parametrat e kategorisë dhe distancës të përcaktuara më sipër.
- Përvijimi vertikal
  - Autostradë
- Projektimi i kryqëzimeve në disnivel (përvijimi horizontal)
- Mbikalimet dhe Nënkalimet
- Detajet tipike të seksionit të kryqëzimit dhe ndërtimit
- Ndërtesat e Stacioneve të tarifës rrugore frontale dhe anësore (Nr. i Stacioneve të tarifës rrugore, vendndodhja e propozuar, nr. i korsive, skema tipike)
- Stacioni i Shërbimit të Shoferëve (SSSH) përfshirë këtu edhe pikat e Karburantit (nr. i SSSH dhe Vendndodhja – atyre që janë ekzistuese ose të reja)

Projekt - Ideja paraqet në formë të përgjithshme zgjidhjen e projektit dhe duhet të përgatisë minimalisht studimet që vijnë:

- Studimin Topografik. Për këtë qëllim, ofertuesi duhet të kryejë një rilevim topografik (i vijave dhe kuotave) të terrenit në fjalë dhe një raport të studimit topografik.
- Studimin Gjeoteknik. Ky studim paraqet informacionin ekzistues të përftuar prej shpimeve apo mostrave të materialeve të nxjerra përpara fazës së Studimit të Projekt- idesë (madje dhe si rezultate të projekteve të kryera më parë). Studimi duhet gjithashtu të trajtojë të gjitha çështjet që lidhen me qëndrueshmërinë e dherave. Kjo merr rëndësi të veçantë sidomos për rastin e ndërtimit të strukturave (ura, tunele, tombino, etj.). Ky studim duhet të shoqërohet edhe me fotografi të cilat, së bashku me hartat dhe shpimet e kryera, do të shërbejnë për të konfirmuar rezultatet e përfshira në Studimin Gjeoteknik.

- Studimin Hidrologjik. Ky studim shërben për të vlerësuar kushtet hidrologjike të zonës ku do të kalojë rruga, përfshirë këtu dhe çështjet që lidhen me drenazhimin e ujërave të rrugës, të cilat janë trajtuar më gjerësisht.
- Studimin për projektimin e shtresave rrugore. Ky studim trajton projektimin e nevojshëm të shtresave rrugore për çdo seksion rrugor. Jetëgjatësia e projektimit të shtresave për materialet elastike, për ato rigjide etj.
- Metodologjinë e ndërtimit. Ky dokument shpjegon mënyrën sesi do të ndërtohet vepra nga pikëpamja teknike, logjistike dhe programore në përputhje me elementët teknikë të projektit dhe rekomandimet e VNM. Ai thekson rreziqet e veçanta me të cilat do të ndeshet dhe mënyrat sesi do të përballohen ato prej tij.
- Raportin e Shpronësimeve. Ky raport paraqet listën e shpronësimeve të nevojshme si dhe çështjeve të tjera përkatëse, së bashku me kërkesat dhe procedurat ligjore që duhet të plotësohen në lidhje me projektin.
- Kërkesat mbi lejet dhe licencat. Ky raport thekson lejet dhe licencat që duhet të marrë Ofertuesi gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit.

*Ofertuesi që do të ofrojë Projektimin më të mirë Konceptual do të vlerësohet me pikët maksimale.*

## **1.2 Metodologjia e punimeve 10 (dhjetë) pikë**

Pas hartimit të Projekt-Idesë konceptuale, Operatori Ekonomik duhet të përgatisë Metodologjinë e grafikut të punimeve, sipas të cilit do të punojë për të përmbushur kërkesat e zbatimit të projektit në kohën, sasinë dhe cilësinë e duhur.

Grafiku i Punimeve do të paraqesë aktivitetet kryesore që do të kryhen nga Operatori Ekonomik për kryerjen me sukses të punimeve sipas propozimit.

Grafiku dhe metodat e punimeve përfshijnë elementët e mëposhtëm:

- Lëvizjen
- Studimin e topografisë dhe përcaktimin e nën-objekteve
- Furnizimin, Transportin dhe Magazinimin e Materialeve
- Aktivitetet e Punimeve në Tokë
- Aktivitetet e Punimeve Hidraulike
- Aktivitetet e Punimeve me Beton
- Aktivitetet e Punimeve të Ndërtimit
- Aktivitetet për punët elektrike dhe mekanike
- Mbrojtjen e punimeve, mjedisit dhe publikut
- Kontrollin Laboratorik, Testimin dhe Kontrollin e Cilësisë së Materialeve
- Përgatitjen e Broshurave për Masat
- Vëzhgimin dhe marrjen në dorëzim të objektit
- Pastrimin e vendit të ndërtimit
- Hartimin e raporteve mujore dhe përfundimtare për punën e bërë.

Ofertuesi që do të ofrojë metodologjinë më të mirë të punimeve do të vlerësohet me pikët maksimale.

**Plani Operacional i Mirëmbajtjes dhe disponueshmerise 10 (dhjetë) pikë**

|           |                                                                                                                                      |                                                                                        |
|-----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|
|           | <b>NATYRA E DEFEKTEVE</b>                                                                                                            |                                                                                        |
